



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I QARKUT VLORË

Nr. 2158 Prot

Vlorë më 23 . 12 .2025

VENDIM

Nr. 26 datë 22 . 12 .2025

**“PËR MIRATIMIN E PJESMARRJES SË KËSHILLIT TË QARKUT VLORË NË
PROJEKTIN “MINOR-MED” PJESË E PROGRAMIT INTERREG GREECE-
ALBANIA 2021-2027”**

Në mbështetje të ligjit Nr. 139/2015, datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore” i ndryshuar, Ligj Nr. 65/2022 datë 15.9.2022 “Për ratifikimin e marrëveshjes Financiare kuadër të partneritetit ndërmjet Republikës së Shqipërisë, përfaqësuar nga Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë, dhe Komisionit Evropian për rregullat specifike të zbatimit të Asistencës Financiare të Be-së për Republikën e Shqipërisë në Kuadër të Instrumentit për Asistencën e Paraanëtarësimit (IPA), Ligj 75/2024 “Për ratifikimin e marrëveshjes së financimit ndërmjet Republikës së Shqipërisë, përfaqësuar nga Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë, Republikës Helene dhe Komisionit Evropian për programin e bashkëpunimit ndërkufitar (INTERREG IV-A) IPA Greqi-Shqipëri 2021–2027”, Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 540, datë 20.9.2023 për përcaktimin e funksioneve, përgjegjësi dhe marrëdhënieve ndërmjet autoriteteve e strukturave për menaxhimin indirekt të asistencës financiare të Bashkimit Evropian nën Instrumentin për Asistencën e Paraanëtarësimit 2021–2027 (IPA III) pikës f të nenit 11 të Vendimit të Këshillit të Qarkut Vlorë, Nr.13, datë 09.07.2024 “Për miratimin e disa ndryshimeve në Rregulloren “Për funksionimin e Administratës së Këshillit të Qarkut Vlorë”, miratuar me VKQ Nr. 12, datë 22.06.2020, Vendimit të Këshillit të Qarkut Vlorë, Nr.7, datë 26.03.2024 “Për autorizimin e Kryetarit të Këshillit të Qarkut Vlorë të nënshkruajë formatet e aplikimit, marrëveshjet e bashkëpunimit, si dhe çdo dokument tjetër për aplikimet në thirrjet e hapura të projekteve me partnerë të huaj”, Marrëveshjes së Partneritetit për projektin “MINOR-MED” “Shërbime mjekësore gjithëpërfshirëse për pakicat në zonën ndërkufitare Greqi-Shqipëri”.

VENDOS:


1. Të miratojë pjesëmarrjen e Këshillit të Qarkut Vlorë në projektin “MINOR-MED” “Shërbime mjekësore gjithëpërfshirëse për pakicat në zonën ndërkufitare Greqi-Shqipëri” (Minority Inclusive Medical Outreach for Remote Mountainous Areas in Greece and Albania) në partneritet me Struktura strategjike Nsrf e Ministrisë së Shëndetësisë si Partner Lider dhe me një buxhet total të projektit prej 887.786,27. €



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I QARKUT VLORE

2. Vlera e buxhetit për Këshillin e Qarkut Vlorë është **195.062,87 €**. Vlera e bashkëfinancimit në zbatimin e projektit, si kontribut i institucionit është në masën 20% vlerë që ngarkon buxhetin e Këshillit të Qarkut Vlorë.
3. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet e gjithë administrata e Këshillit të Qarkut Vlorë.
4. Ky Vendim hyn në fuqi sipas pikës 3, neni 78 të Ligjit Nr. 139/2015, datë 17.12.2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”, i ndryshuar.

KRYETARI


Ervis MOÇKA



Shpallur nga Prefekti i Qarkut Vlorë me shkresë Nr. ____ Prot, datë ____ . ____ .2025

Adresa: Këshilli i Qarkut Vlorë
Pallati i Kulturës “Labëria”, Vlorë
Vlorë (AL)

Web site: www.qarkuvlore.gov.al
E-mail: info@qarkuvlore.gov.al
Tel: +35533421608



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I QARKUT VLORE

RELACION

**Projekti MINOR-MED “Shërbime mjekësore gjithëpërfshirëse për pakicat në zonën
ndërkufitare Greqi-Shqipëri” (Minority Inclusive Medical Outreach for Remote
Mountainous Areas in Greece and Albania).**

Projekti MINOR-MED ka për qëllim forcimin e qëndrueshmërisë së sistemit shëndetësor dhe përmirësimin e reagimit ndaj emergjencave shëndetësore në zonat rurale të largëta, dhe minoritare përmes përdorimit të teknologjive digjitale të avancuara dhe zgjidhjeve inovative mjekësore. Projekti fokusohet në rritjen e aksesit në shërbime shëndetësore cilësore, veçanërisht për komunitetin minoritar duke nxitur njëkohësisht bashkëpunimin ndërkufitar ndërmjet Greqisë dhe Shqipërisë.

Ndërhyrjet e projektit synojnë përmirësimin e monitorimit shëndetësor, menaxhimin më efikas të situatave emergjente dhe mbështetjen e vendimmarrjes mjekësore përmes mbledhjes dhe analizës së të dhënave në kohë reale. Projekti parashikon vendosjen e infrastrukturës mjekësore inteligjente, përdorimin e pajisjeve mjekësore të pajisura me teknologji IoT, si dhe zbatimin e sistemeve të bazuara në Inteligjencë Artificiale për analiza parashikuese dhe asistencë në vendimmarrje.

Në vëmendje të këtij projekti është zhvillimi i shërbimeve të telemjekësisë dhe monitorimit në distancë, të cilat do të mundësojnë ofrimin e shërbimeve shëndetësore edhe në zonat me akses të kufizuar. Paralelisht, projekti parashikon organizimin e trajnimeve të specializuara për stafin shëndetësor, me qëllim rritjen e kapaciteteve profesionale për përdorimin e teknologjive të reja dhe menaxhimin e emergjencave shëndetësore.

Këshilli i Qarkut Vlorë është PB2 në projektin MINOR-MED me një buxhet prej **195.062,87 €** dhe me partnerë si Partner Lider - Strategic Structure NSRF of Ministry of Health (Greqi), e cila udhëheq dhe koordinon zbatimin e projektit në nivel programi; PB2 General Hospital at Filiales (Greqi), që kontribuon me ekspertizë klinike dhe përfshirje direkte në shërbimet shëndetësore dhe emergjencat mjekësore; PB4 “ATHENA” – Research and Innovation Centre in Information, Communication and Knowledge Technology (Greqi), i cili mbështet zhvillimin dhe aplikimin e zgjidhjeve teknologjike, platformave digjitale dhe sistemeve inteligjente të projektit, PB5 NGO “DIAGNOSIS”, e angazhuar në mbështetjen sociale, ndërgjegjësimin e komuniteteve dhe përfshirjen e grupeve vulnerabël në shërbimet shëndetësore.

Këshilli i Qarkut Vlorë luan një rol të rëndësishëm në koordinimin dhe zbatimin e tij në territorin e **Bashkisë Finiq**, në bashkëpunim me **NJKSHP Delvinë** dhe **Qendrën Shëndetësore të Finiqit**. Projekti do të implementohet në fshatrat **Aliko, Dhiver, Grazhdan,**



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I QARKUT VLORË

Këshilli i Qarkut Vlorë luan një rol të rëndësishëm në koordinimin dhe zbatimin e tij në territorin e **Bashkisë Finiq**, në bashkëpunim me **NJKSHP Delvinë** dhe **Qendrën Shëndetësore të Finiqit**. Projekti do të implementohet në fshatrat **Aliko, Dhiver, Grazhdan, Karroq, Dhrovjan, Zminec, Malcan dhe Leshnicë**, zona këto me nevoja të shtuara për shërbime shëndetësore të aksesueshme dhe të shpejta.

Projekti pritet të sjellë:

- përmirësim të aksesit në shërbime shëndetësore për komunitetet rurale dhe të izoluar;
- rritje të kapaciteteve të reagimit ndaj emergjencave shëndetësore;
- përdorim më efikas të burimeve shëndetësore përmes teknologjive digjitale;
- forcim të kapaciteteve institucionale dhe profesionale të stafit shëndetësor;
- përmirësim të qëndrueshmërisë së sistemit shëndetësor lokal.

Projekti **MINOR-MED** përbën një hap të rëndësishëm në modernizimin e shërbimeve shëndetësore, forcimin e bashkëpunimit ndërkufitar Shqipëri–Greqi dhe përmirësimin e cilësisë së jetës për komunitetet lokale, duke kontribuar drejtpërdrejt në rritjen e sigurisë shëndetësore dhe zhvillimin e qëndrueshëm rajonal.

Ilda Lamaj

Specialist për Arsimit, Kulturën, Turizmin, Çështjet Sociale dhe Zhvillimin e Projekteve